

# PLATFORMË

## (E KANDIDIMIT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË)

### **Motivet dhe qëllimet e kandidimit**

Nevoja për reformimin e sistemit të prokurorisë, për ta ngritur atë në nivelin e përgjegjësive të reja që shoqëria dhe rendi ynë juridik vendosin përpara saj, u materializua me ndryshimet kushtetuese të miratuara me ligjin nr.76/2016, datë 22.07.2016. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP-ja), është një nga institucionet e reja që u krijua me këto ndryshime kushtetuese, për të garantuar pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

Sistemi i Prokurorisë tashmë ka marrë përcaktim të qartë, veçanërisht për sa i përket garancive kushtetuese që i njihen prokurorit në përmbushjen e detyrës dhe misionit për të realizuar ndjekjen penale. Por ndër përcaktimet kushtetuese më të rëndësishme, natyrisht që është ajo e garantimit të pavarësisë së prokurorit, e cila përbën edhe ndryshimin e shumëkërkuar, dhe të gjithëpranuar edhe nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare.

Ky realitet i ri juridik, institucional, është shtysë e rëndësishme për çdo prokuror, që beson në këto vlera, për tu bërë pjesë e tyre dhe për të kontribuar, qoftë edhe në mënyrë modeste, në suksesin dhe efektivitetin e KLP-së. Duke besuar në këto vlera, shpreh angazhimin dhe motivimin maksimal për t'u bërë pjesë e përpjekjes për konsolidimin e këtij organi dhe rritjen e efektivitetit të tij.

Vitet e gjata të punës në prokurori, eksperiencia prej mbi 27 vite, në të gjitha pozicionet e punës në prokurori, duke filluar nga ajo e hetuesit dhe oficerit të policisë gjyqësore, për të vazhduar më pas me 24 vite si prokuror në disa prokurori të shkallës së parë, në atë të Hasit, Kukësit, Krujës, Kurbinit, Durrësit, Lezhës dhe Tiranës, si dhe puna si drejtues në disa prej këtyre prokurorive, në atë të Hasit, Krujës, Kurbinit dhe Lezhës, më kanë dhënë mundësinë e njohjes në detaje të problematikave dhe realitetit të sistemit të prokurorisë, më kanë dhënë mundësi të njoh praktikat e mira të punës në këto prokurori, të njoh problemet dhe vështësitë me të cilat përballen prokurorët, dhe jo vetëm ata, por edhe oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata në këto prokurori, të njoh nevojat emergjente që kanë këto prokurori dhe në tërësi sistemi i prokurorisë, së pari për burime njerëzore, por edhe për burime të shtuara materiale dhe financiare.

Puna në prokurori për një periudhë relativisht të gjatë kohe, e cila është pothuaj gjysma e jetës time, e ka rritur ndjeshmërinë tek unë ndaj sistemit të prokurorisë dhe natyrisht edhe dëshirën

për të kontribuar në forcimin e rolit dhe statusit të prokurorit, sipas standarteve më të larta, për të garantuar një pavarësi reale të prokurorit si dhe forcimin e integritetit të tij.

## **Qasja e platformës**

Duke vlerësuar, rëndësinë e organit të prokurorisë për shoqërinë në tërësi, detyrimet ligjore, të ndërthurura këto edhe me vështirësitë e reformimit në tërësi të sistemit të prokurorisë, natyrisht që kërkohet përkushtim, vëmendje, vullnet dhe punë madhore për të realizuar arritjen e qëllimeve dhe përmbushjen e përgjegjësive kushtetuese.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është organ kushtetues, kolegjal, i përbërë nga 11 anëtar, 6 prej të cilëve zgjidhen nga radhët e prokurorëve, duke krijuar kështu mundësi reale që prokurorët jo vetëm të kenë zërin e tyre në procesin kompleks dhe mjaft delikat të reformimit të sistemit dhe të konsolidimit të figurës së prokurorit, por krijojnë mundësi reale që prokurorët të përcaktojnë vetë politikën dhe strategjinë që ky organ do të ndjek në këtë proces.

Kompetencat dhe përgjegjësit e këtij institucionit, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me emrimin dhe promovimin e prokurorëve, rregullimet përmes akteve nënligjore të veprimtarisë së prokurorit, përgjegjësitë për të propozuar dhe siguruar buxhet të mjaftueshëm për një aktivitet normal të sistemit, e bëjnë me shumë ndjeshmëri procesin e zgjedhjes së anëtarëve prokuror në këtë organ.

KLP-ja si organ i qeverisjes së prokurorëve ka përgjegjësi dhe detyrime të qarta e të mirëpërcaktuara në ligj. Përgjegjësi e plotë për sistemin e prokurorisë dhe mirëfunksionimin e tij dhe detyrime për të siguruar kushte që prokurorët të mund të ushtrojnë të pavaruar detyrën e tyre, të garantojë mbrojtje reale për të mos lejuar cënimin e integritetit të prokurorëve në ushtrimin e detyrës, të zhvillojë dhe të garantojë mundësi të barabarta për karrierë për çdo prokuror, si dhe të garantojë respektimin e plotë të statusit të prokurorit.

Përcaktimi i një strategjie të saktë, gjithëpërfshirëse, bashkëkohore, e harmonizuar me strategjinë e KLP-së në tërësi, si dhe përcaktimi i objektivave të qarta që synohet për tu përmbushur gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të KLP-së, ka rëndësi pasi mundëson ndjekjen e objektivave thelbësore, duke u dhënë vlerën e duhur burimeve në dispozicion për t'i arritur këto objektiva, duke përqafuar progresin gjatë evoluimit, duke identifikuar dhe adresuar problematikat e hasura, dhe më e rëndësishmja arritja konsistente e rezultateve.

Mbajtja e kontakteve nga anëtarët e KLP-s me prokurorët jo vetëm në periudhën apo procesin e zgjedhjes por në gjithë periudhën e ushtrimit të funksionit, përbën faktor potencial që veprimtaria e këtij organi të jetë efektive. Anëtarët e KLP-së duhet të zhvillojnë takime në vijë me prokurorët dhe me drejtuesit e prokurorisë, pavarësisht ndërveprimit të përditshëm, me fokus rishikimin e strategjisë për objektivat primare, masat dhe iniciativat që duhet të ndërmerren. Gjatë këtyre takimeve, duhet të diskutohet edhe mbi performancën dhe vendimmarrjen e KLP-së, në mënyrë të tillë, që të përmirësohet funksionimi dhe të arrihen

rezultate në nivelin e pritshmërive që ka trupa e prokurorëve ndaj këtij organi, shumica e të cilit zgjidhen prej tyre.

Natyrisht puna dhe strategjia e KLP-së duhet të harmonizohet edhe me strategjinë Kombëtare të Sigurisë, me strategjinë e Prokurorisë së Përgjithshme dhe planin e saj të veprimit, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komisionit Europian dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë.

### **Misioni/Vizioni/Vlerat**

Funksioni i anëtarit të KLP-së do të ushtrohet duke patur si mision sigurimin e një sistemi të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efektiv të hetimit dhe ndjekjes penale nga prokurorët e rekrutuar në bazë të meritës, të vlerësuar në bazë të rezultateve në punë e të mbikqyrur sipas standardeve të larta, si dhe ofrimi i burimeve te nevojshme njerezore dhe infrastrukture.

Drejtësi efikase, efektive, transparente, llogaridhënëse dhe profesionale që gëzon besimin e publikut.

Ushtrimi i funksionit të anëtarit të KLP-së duhet të karakterizohet nga vlerat, si:

- Pavërësi në ushtrimin e funksionit dhe jashtë ndikimit të faktorëve apo pushteteve të tjerë.
- Integriteti dhe etika e lartë;
- Promovimi i qasjes së barabartë në shërbimet e sistemit të prokurorisë për të gjithë pa dallim;
- Avancimi i vazhdueshëm i sistemit të administrimit dhe menaxhimit;
- Ofrimi i shërbimeve profesionale, efikase, efektive dhe të bazuara në ligj.
- Transparencë në vendimmarrje;

### **Objektivat**

Synimi im kryesor është të kontribuoj me të gjitha mundësitë dhe në vijëmbësi për forcimin, konsolidimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të reformuar të prokurorisë, me prokuror që ushtrojnë detyrën me përgjegjesi dhe në pavarësi, që gëzojnë integritet dhe moral të lartë, të cilëve u garantohet mbrojtje nga çdo cënim në ushtrimin e ligjshëm të detyrës, u garantohet respektimi i statusit, u garantohet barazi dhe drejtësi për karrierë, por dhe u kërkohet llogari për punën që ata kryejnë.

### **Përmirësimi i sistemit të administrimit të prokurorisë.**

Aktualisht të gjithë prokurorët, dhe sistemi i prokurorisë në tërësi, po përballen me një ngarkesë pune të rritur. Për secilin nga ne është e qartë se ngarkesa e punës vit pa viti shtohet, ndërkohë që numri i prokurorëve mbetet po ai, madje në këtë periudhë për shkak të procesit të rivlerësimit ky numër është pakësuar ndjeshëm.

Gjithashtu secili nga ne e ka të qartë se puna e prokurorit nuk është thjesht punë në kuptimin e punës fizike dhe intelektuale që ai duhet të kryejë brenda një orari. Puna e prokurorit është shumë më shumë se kaq. Para së gjithash është punë që kërkon mendim të qartë për secilin rast që ndjek, është punë që ndërvaret ndjeshëm nga struktura të tjera, është punë që kërkon respektimin rigoroz të procedurës dhe në çdo rast kërkon analizë dhe vendimarrje të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Situata aktuale kërkon gjetjen e modaliteteve të nevojshme, nëpërmjet rritjes së numrit të prokurorëve si dhe shtimit të burimeve njerëzore në pozicionet e tjera të punës në prokurori, për ti ardhur në ndihmë prokurorëve në përballimin e ngarkesës me të cilën ata po ballafaqohen. Rëndësi themelore merr krijimi i stafit mbështetës të prokurorit, nëpërmjet ndihmësit, apo sekretarit.

Për më tepër duhet të investohet në përmirësimin e kushteve të punës dhe shërbimeve tjera në infrastrukturë. Sot vetëm disa prokurori ofrojnë mundësinë që gjykata dhe Prokuroria pranë saj të kenë të njëjtën godinë. Prokurorët në disa prokurori janë të detyruar që të lëvizin, madje me disa kilometra për të marrë pjesë në seancat gjyqësore. Kjo ka krijuar vështirësi të mëdha në administrimin e punës individuale të prokurorëve, duke sjellë zvarritje të hetimeve, hetime të përcipta dhe në disa raste joefektive.

Gjithashtu godinat aktuale, në disa prokurori nuk ofrojnë kushte mbështetëse për prokurorët, duke filluar nga ambjentet e punës, si zyra, sekretari, arkiva, parkimi, apo dhe kushtet e ruajtjes fizike të tyre.

Është detyrim dhe përgjegjësi e KLP-së që duke bashkëpunuar edhe me faktor dhe me struktura të tjera të sistemit, siç është Prokurori i Përgjithshëm, të gjejë modalitetet e përshtatshme për të ofruar zgjidhje dhe garantuar kushte, duke propozuar ndërhyrje dhe iniciativa ligjore, me qëllim krijimin dhe konsolidimin e një sistemi prokurorie si ato të vendeve të tjera evropiane ku aspirojmë të shkojmë apo edhe si ato të vendeve që kemi pranë.

#### **Avancim i sistemit të rekrutimit, transferimit, ngritjes në detyrë të prokurorëve.**

Rekrutimi i prokurorëve në vitet e fundit, komandimet, transferimet dhe emërimet e drejtuesve të prokurorivë, ka qenë ndër prioritetet kryesore të Këshillit, për shkak të vakancave që janë krijuar. Është e rëndësishme që të garantohen procese kredibile të rekrutimit, ngritjes në detyrë, apo transferimit, të besueshme dhe të bazuara në standarde të pranuara ndërkombëtare, të vlerësuara edhe nga monitoruesit ndërkombëtarë të këtyre proceseve. Këshilli duhet të promovojë qasjen e ndryshimit të vazhdueshëm dhe avancimit të këtyre proceseve, që prokurorët të bësojnë në punën e tyre dhe në drejtësinë e Këshillit.

Krahas proceseve të lartpërmendura, në baza të rregullta duhet të analizohet numri i prokurorëve për secilën prokurori, relevanca me ngarkesën në punë dhe në përshtatshmëri të bëhen transferimet dhe ngritja në detyrë. Në këtë mënyrë do të mundësohet edhe zhvillimi në karrierë për prokurorët ambiciozë, duke u mbështetur në rezultatet e punës.

### **Rishikimi i paketës së akteve nënligjore.**

Këshilli ka treguar rezultat të dukshëm në hartimin në tërësi të kornizës nënligjore, gjë që ka bërë të mundur të krijohen praktika pune efikase dhe transparente si dhe të fokusuara në rezultate të planifikuara dhe të matshme. Megjithatë, ndryshimi i vazhdueshëm i legjislacionit, shtron nevojën e rishikimit dhe plotësim të akteve nënligjore të Këshillit, duke synuar avancim në proceset e punës, rritje të efikasitetit, efektivitetit dhe mbikqyrje të sistemit të prokurorisë.

Në këtë drejtim, mendoj se i duhet dhënë prioritet rishikimit të akteve që normojnë sistemin e karrierës dhe të transferimit për të rritur besimin e prokurorëve në vlerësimin e meritokracisë. Prokurorët duhet të kujdesen për performancën e tyre dhe zhvillimi në karrierë për secilin prokuror duhet të jetë i garantuar dhe proporcional me performancën.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjithashtu duhet të ketë rol proaktiv në ndryshimet ligjore që rregullojnë aspekte të sistemit të drejtësisë përmes kontributit në koncept-akte, propozim-ndryshime të dispozitave ligjore, pjesëmarrje në grupe punuese, tryeza shkencore dhe aktivitete të ngjashme që avancojnë drejtësinë penale dhe sistemin prokurorial në veçanti.

### **Vlerësimi i performancës dhe integritetit të prokurorëve.**

Mbikqyrja e punës së prokurorëve është ndër elementet më të rëndësishme për një sistem prokurorial profesional dhe etik, i cili do të jetë në mbrojtje të vlerave më të larta të shoqërisë. Për këtë duhen normuar dhe gjetur mekanizma efektiv, që mbikëqyrin aktivitetin e prokurorisë, që vlerësojnë drejtë dhe në kohë punën e prokurorëve, respektimin e rregullave të normuara përmes akteve ligjore dhe nënligjore.

Mekanizmat aktualë duhet të përmirësohen për të mundësuar vlerësime të drejta të punës së prokurorëve, në funksion të fuqizimit të llogaridhënies dhe integritetit. Por, llogaridhënia nuk duhet të shikohet apo përdoret si mjet ndëshkimi për prokurorët, apo si qëllim i tillë në vetvete. Prokurori brenda kornizës etike dhe ligjore duhet të ndihet i pacënuar dhe i mbrojtur nga KLP-ja në rast të cënimit të padrejtë.

Vlerësimi i performancës së prokurorëve është proces esencial për avancimin e mëtejshëm të efikasitetit dhe profesionalizmit të institucionit të Prokurorisë. Tashmë, sistemi i vlerësimit të performancës është miratuar, por ai duhet konsoliduar. Këshilli duhet të krijojë bazë të mirë për avancimin e të këtij sistemi, i cili në fokus do të ketë objektivitetin dhe meritokracinë për të mundësuar zhvillimin e karrierës të sistemit prokurorial.

### **Ngritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve.**

Rezultatet pozitive në sistemin e prokurorisë nuk mund të arrihen pa një nivel të lartë profesional të prokurorëve dhe personelit mbështetës. Rëndësia e trajnimit të prokurorëve

është e specifikuar në mekanizmat ndërkombëtarë, si në: Parimet themelore të OKB-së për pavarësinë e Gjyqësorit, të miratuara në vitin 1985, por edhe me aktet e Këshillit të Evropës, si: Rekomandimi nr. R (94) 12 për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve, i miratuar në vitin 1994, Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve, e cila i referohej paragrafit 11 të Opinionit nr.1 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE), në vitin 1998. Në frymën e këtyre akteve janë edhe rekomandimet dhe opinionet e Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (CCPE). Këshilli do të krijojë mekanizma të nevojshëm për të mbështetur Shkollën e Magjistraturës, që është dhe autoriteti përgjegjës për zhvillimin dhe cilësinë e programeve trajnuese dhe trajnimeve, mekanizma për vlerësimin e nevojave për trajnime, për pjesëmarrjen në trajnime dhe programe shkëmbimi, si dhe për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për vlerësimin e ndikimit të trajnimeve. Këshilli duhet të angazhohet për të krijuar mundësi të barabarta të pjesëmarrjes në trajnime për të gjithë prokurorët, në mënyrë që kjo pjesëmarrje të jetë mbështetje e fuqishme për zhvillimin e karrierës së tyre profesionale.

### **Rritja e transparencës dhe bashkëpunimit.**

Transparenca dhe komunikimi me mediat, publikun dhe shoqërinë civile konsiderohet si çelës dhe garantues i suksesit për veprimtarinë e KLP-së. Këshilli në këtë periudhë të funksionimit të tij ka patur angazhim të shtuar për forcimin e këtyre komponentëve, por konsiderojmë se ky angazhim duhet vazhduar edhe më tutje. Këshilli do të vazhdojë të ketë transparencë në punën e tij qoftë nëpërmjet takimeve të hapura, por edhe të formave të tjera të komunikimit. Zhvillimi i kapaciteteve të resurseve njerëzore në fushën e komunikimit publik dhe nxjerrja e një udhëzuesi praktik duhet të jenë synime të Këshillit, me qëllim të ngritjes së rolit proaktiv në komunikimin publik.

Duke parë realitetin mediatik aktual, në të cilin shpesh herë prokurorë të caktuar janë vënë në qëndër të tyre, duhet krijuar një praktikë efikase për adresimin e kësaj problematike, e cila tashmë ka dhe kornizë ligjore.

Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare është i përcaktuar me ligjin organik, aktet e tjera nënligjore dhe strategjitë përkatëse. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me të cilat ndërvepron Këshilli, me theks të veçantë: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, Policia e Shtetit, etj. Po ashtu, ky bashkëpunim do të përqendrohet edhe në zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale me institucione të ngjashme evropiane dhe botërore.

Duke patur mbështetjen tuaj të ndëruar kolegë, platforma do të jetë e vlefshme dhe do të zbatohet për periudhën e mandatit si anëtar i KLP-së, duke qenë i hapur për mendimet dhe sugjerimet e gjithësecilit prej jush.

**Me shumë konsideratë,  
Zeqir HODA**

**Prokuror i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë**

**Tiranë, më 02.09.2021**